



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

01-039-5 05-04-2016
Br. ISTOG-ISTOK
ISTOG-ISTOK



Komuna e Istogut

Opstina Istok

Municipality of Istog

01 Nr.37/2016

Datë: 30.03.2016

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

tel: 038/ 200 43 814

KUVENDI I KOMUNËS

PLANI LOKAL I VEPRIMIT RINOR 2016-2019

MARS - 2016

Në bazë të nenit 17 shkronja r) të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Ligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrje të rinisë Ligji Nr. 03/L-145 dhe Udhëzimit Administrativ për përgjegjësit dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillit Nr.9/2010 dhe Statutit të Komunës 01 Nr.62/2010 në mbledhjen e mbajtur më datë me: 30.03.2016 miraton:

PLANI LOKAL I VEPRIMIT RINOR

(2016-2019)

Qëllimi

Plani Lokal i Veprimit Rinor është dokument strategjik i cili përfshin të gjithë të rinjtë.

Ky plan ka për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi për zhvillimin e një shoqërie demokratike, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror.

Po ashtu ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve rinore si dhe vedijësimin e rinise mbi dukurit negative.

Përkufizimet:

MKRS - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

DA-SKSR - Drejtoria për Arsim-Sektori për Kulturë, Sport dhe Rini

KVRL - Këshilli i Veprimit Rinor Lokal

QR - Qendra Rinore

DSHMS - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

DUKMM - Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

FSK - Forca e Sigurisë së Kosovës

Bazuar në Strategjinë Kosovare për Rini 2013-2017 i cili është dokument i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i hartuar nga departamenti i Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është hartuar Plani Lokal i Veprimit Rinor nga Këshilli Lokal i Veprimit Rinor në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim-Sektorin për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe me kontributin e OJQ-ve Rinore.

Plani lokal i veprimit rinor

Plani Lokal i Veprimit Rinor nënkupton politikën lokale për të rinjtë për periudhën 2016-2019, si dhe mënyrat e qasjes së politikave rinore komunale të të rinjve dhe nevojave të tyre. Ky Plan është gjithëpërfshirës për të rinjtë, duke u bazuar në nevojat dhe pjesëmarrjen e të rinjve në arsimim, punësim, shëndetësi gjithashtu ka të bëjë edhe me çështjet dhe problemet me të cilat të rinjtë ballafaqohen çdo ditë.

Plani lokal i veprimit rinor synon që të përmirësojë gjendjen e të rinjve, identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të të rinjve duke gjetur mënyra dhe mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në Komunën, në bashkëpunim me institucionet lokale, qendrore dhe organizatat Joqeveritare

Përfitimet e të rinjve

Plani i Lokal i Veprimit Rinor hartohet për të rinjtë e moshave 15 – 24 vjeç dhe çdokush që i takon kësaj grup moshe do të përfitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pa përjashtuar përkatësinë etnike, gjinore e racore.

Plani është hartuar bazuar në politikat rinore të Sektorit të Rinisë të Drejtorisë për Arsim përfshirë një numër të veprimeve në zonat rurale dhe urbane të Istogut.

PLVR promovon bashkëpunimin ndërmjet organizatave Rinore dhe Qeverisë Komunale dhe në të njëjtën kohë ndërlidhë politikat ndër-sektoriale në mes të drejtorive pranë Komunës, që ndërlidhet me të rinjtë në fushën e politikave dhe programeve rinore.

Ky plan mund të pasurohet në vite të ardhshme duke bashkëpunuar me Drejtorinë për Arsim, përkatësisht Sektorin e Rinisë dhe Këshillin i veprimit rinor lokal të (KVRL-së) në Istog.

Pas fillimit të zbatimit të projektit, në koordinim të plotë të Sektorit të Rinisë dhe organizatave implementuese, për Kuvendin e Këshillit Veprimit Rinor Lokal (KVRL), në të cilin Kuvend ishin ftuar shumë organizata joqeveritare, si dhe grupet tjera formale, siç janë ato të shkollave të mesme të Istogut si dhe përfaqësues nga Asambleja e të rinjve.

Ky Kuvend përveç delegatëve dhe OJQ-ve morën pjesë edhe përfaqësues të Sektorit të Rinisë në kuadër të Drejtorisë për Arsim, ku shprehën mbështetjen e plotë të strukturave që do të dalin nga ky Kuvend dhe për rininë në përgjithësi .

Monitorimi i punimeve të Kuvendit të KVRL-së është bërë nga Sektori i Rinisë në Drejtorinë e Arsimit dhe organizata Qeveritare Gjermane GTZ dhe nga OSBE .

Në këtë Kuvend u zgjodhën strukturat drejtuese të KVRL-së si me poshtë :

Këshilli i përbërë prej 9 anëtarësh i KVRL-së

Kryetari KVRL-së

Nënkryetari KVRL-së

Sekretari KVRL-së

Koordinatori KVRL-së

Këshilli lokal i veprimit rinor

Këshilli lokal i veprimit rinor është formacion këshillues i organizatave rinore, që veprojnë në nivelin lokal dhe përfaqësojnë interesat e organizatave rinore dhe të rinjve tek institucionet e pushtetit lokal

Këshilli lokal i veprimit rinor është organ këshillëdhënës nëpërmes të cilit rinia mund t'i adresojë brengat, shqetësimet dhe rekomandimet e veta të Kryetari i Komunës dhe ka për qëllim hulumtimin e gjendjes së rinisë dhe të bashkojë organizata të ndryshme brenda një trupi, me qëllim të plotësimit të nevojave të rinis.

Pjesëmarrja në KLVR

Nëse jeni anëtar i ndonjë organizate joqeveritare, apo i ndonjë grupi tjetër rinor të organizuar dhe jeni të moshës 15–24 vjeç mund të jeni i deleguar si pjesëmarrës në Kuvendet vjetore që do t'i mbajë KVRL-ja.

Po ashtu, përmes projekteve të zbatuara nga KVRL, në çdo kohë dhe në çdo vend, mund të jeni pjesë e tyre.

Zbulimi i talenteve të rinj

Zbulimi i talenteve të rijë në fusha të ndryshme si në sport, art, vallëzim, dhe këndim. Të gjitha këto do të bëhen me anë të organizimit të turnirëve, ekspozitave dhe kurseve të ndryshme.

1 Qershori–dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Organizimi i orës letrare i cili do të mbahet 3 vjet radhazi, ku do të marrin pjesë nxënës nga shkollat fillore të komunës së Istogut.

Organizimi i një programi kulturo-artistik për fëmijë.

Aktivitetet për personat me aftësi të kufizuara

Vizitë në Handikos.

Veshja e maskotave për argëtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Ekskursion së bashku me personat me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet senzibilizuese

Shfaqja e filmave të shkurtër në shkollat me të mëdha të Istogut, që përmbajnë material që i vetëdisojnë të rinjtë kundër dhunës në familje, rolin e femrës në familje e shoqëri, dhe trafikimin me qenie njerëzore.

Aftësimi profesional i të rinjve dhe përgatitja për tregun e punës

Trajnime të ndryshme për ndërmarrësi, hartime të planeve të biznesit, menaxhim projektesh, informatikë e të tjera.

Mbështetja e të rinjve në zona rurale

Aktivitete të cilat do të rrisin vetëdijesimin për rëndësinë e vendimmarrjes të të rinjve në aktivitete rinore. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve duke themeluar klube në zonat rurale, dhe duke i vizituar shkollat në vendet rurale.

Kampi i përbashkët i të rive me FSK-në

Trajnimi i të rinjve nga ana e FSK-së, në aftësitë për jetën dhe menaxhimin e situatave në rast të rrezikut.

Aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit

Aktiviteti për pastrimin e qytetit, mbajtja e trajnimeve që vetëdisojnë të rinjtë për rëndësinë e një mjedisi të pastër.

Shfaqja e një filmi të shkurtër i cili ka për qëllim vetëdijesimin e të rinjve me anët negative që i sjellë ndotja e planetit.

Dita e Rinis

Organizimi i turneve sportive, art, muzikë, vallëzim. Trajnim një ditë me kryetarët e klasave për të drejtat e nxënësve në shkollë, dhe obligimet e tyre ndaj shkollës.

Organizimi i kurseve të ndryshme pa pagesë

Organizimi i kurseve të ndryshme në matematikë, gjuhë shqipe & angleze, vallëzim, pikturë, dhe aktrim.

Aktivitetet humanitare

Mbledhja e rrobave dhe shpërndarja e tyre tek personat me nevojë.

Mbledhja e të hollave nga disa biznese me të mëdha në komunën e Istogut, për familjet në nevojë.

Panairi i shitjes së ushqimeve tradicionale.

Trajnimet

Trajnim rreth vetëdijesimit të të rinjve për vullnetarizmin.

Trajnim për Krimet Kibernetike.

Trajnim se si të hartojmë një projekt propozim.

Trajnim për punën me media.

Trajnim për sensibilizimin e të rinjve në mbrojtjen e mjedisit.

Trajnim rreth aftësisimit për karrierë dhe

Trajnim për njohjen e të drejtave të tyre sipas ligjeve.

Garat në çiklizëm

Gara që do të organizohen në pjesët rurale të Istogut, të cilat do të kenë karakter garues.

Tryeza, debate për rolin e të rinjve në vendimmarrje

Është e rëndësishme që të vazhdohet me vetëdijesimin për rolin dhe rëndësinë që kanë të rinjtë të jenë pjesë e vendimmarrjes, sidomos fushat që prekin drejtpërdrejtë jetën e rinisë qoftë në institucionet edukative-arsimore ku një nderë kërkesat do të jetë që të rinjtë të kenë një përfaqësues në vendin ku ndahen bursat për studentët me të dalluar, për ata në kushte me të renda sociale etj, qoftë në institucionet tjera.

Fushatë vetëdijesimi për regjistrimin në zyrën e punësimit

Fushatë vetëdijësuese për të rinjtë për ekzistimin e zyrës së punësimit, nxjerrja e statistikave që tregojnë se sa nga të rinjtë që përfundojnë shkollimin e mesëm janë të papunë. Këto fushata vetëdijesimi do të mbahen në gjithë komunën e Istogut.

Takime me maturantët

Diskutimi i çështjeve pas përfundimit të maturës, dhe orientimi në drejtime universitare. Prezantimi i universiteteve dhe fakulteteve në një ditë të caktuar.

Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i dukurive negative

Projektet në kuadër të kësaj fushe do të ishin të ndërlidhura me datat e caktuara siç janë :

24 Marsi- Dita Evropiane e Parqeve. Në kuadër të kësaj dite do të mbahen fushata për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e parqeve si dhe pengimin për shkatërrimin e tyre.

31 Maji- Dita Ndërkombëtare kundër Duhanit. Në kuadër të kësaj dite do të mbahen fushata vetëdijësuese për të rinjtë kundër duhanit dhe zbatimit të ligjit kundër duhanit.

28 Qershori- Dita kundër narkotikëve. Në këtë ditë me organizime dhe seminare të ndryshme do të mund të ngrihej vetëdija nga pasojat që sjellë narkomania dhe në të njëjtën kohë do të mund të marrin shumë udhëzime për parandalimin e kësaj dukurie.

1 Dhjetori- Dita Ndërkombëtare kundër HIV/AIDS-it. Në kuadër të kësaj dite do të mbahen fushata vetëdijësuese për të rinjtë.

Ky plan miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe zbatimi i tij bëhet në bashkëpunim me partnerët-palët tjera të interesit: institucionet lokale, rajonale, organizatat jo qeveritare, sektori i biznesit, apo institucione tjera financiare, në mënyrë që të bëhen pjesë e PLVR.

Buxheti i planifikuar për zbatimin e aktiviteteve të parapara

Objektivat e politikës	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Institucione përgjegjëse	Institucione Partnerë	Planifikimi			Buxheti
					2016	2017	2018	
	Edukimi Shëndetësor dhe Parandalimi i Dukurive Negative	Aftësimi rreth problemeve shëndetësore	MSH DA-SKSR	KVRL, OJQ-të	2500	2500	2500	7500
	Aktivitetet sportive	Zbulimi i talenteve të rinj	DA-Spektori për kulturë, Sport dhe rini	OJQ-të	2000	2000	2000	6000
	1 Qershori	Pjesëmarrja e fëmijëve me punime	DA-SKSR	OJQ-të	500	500	500	1500
	Aktiviteti për persona me aftësi të kufizuara	Inkuadrimi i personave me aftësi të kufizuara	DA-SKSR	OJQ-të	750	750	750	2250
	Aktivitetet e qëndrueshme	Vetëdijësimi i të rinjve	DA-SKSR	OJQ-të	0	0	0	0
	Aftësimi profesional	Përgatitja e të rinjve për tregun e punës	MPMS	DKRS	500	500	500	1500
	Mbështetja e të rinjve në zonat rurale	Informimi i rinisë zonat rurale për KVRL	Komuna Istog	OJQ-të	100	100	100	300

	Kamp i përbashkët i të rinjve me FKS-në	Aftësimi për jetën në menaxhimin e situatave	MFSK	FSK	2000			2000
	Aktivitet për mbrojtjen e mjedisit	Ngritja e njohurive për rëndësinë mjedisore	MPH	KVRL, OJQ-të, Grupet Vullnetare	2500	2500	2500	7500
	Java e Rinisë	Mobilizimi i rinisë, bashkëpunimi në mes vete si dhe promovimi i rolit të rinisë në shoqëri.	DA-SKSR	KVRL, OJQ-të, Grupet Vullnetare	700	700	700	2100
	Gara në Çiklizëm	Rinia aktive	DA-SKSR	KVRL, OJQ-të	1000	1000	1000	3000
	Organizimi i kurseve të ndryshme pa pagesë	Ngritja e nivelit të të rinjve në këto fusha	MASHT DA-SKSR	KVRL	1200	1200	1200	3600
	Takime me Maturantët	Përgatitja e Maturantëve për studime Universitare	DA-SKSR	KVRL	500	500	500	1500
	Tryeza Debati mbi rolin e të Rinjve në Vendimarrje	Dëgjimi i zërit tek të Rinjtë	DA-SKSR	KVRL, OJQ-të	500	500	500	1500
					14750	12750	12750	40,250

Shuma e përgjithshme e buxhetit për PLVR-në 2016-2019 Total:40,250

Me rishikimin e buxhetit për vitin 2016 do të ndahet buxhet për projektet e parapara në këtë Planë që janë planifikuar të realizohen në këtë vit.

Plani Lokal i Veprimeve Rinor hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Kuvend.



Kryesuesi i Kuvendit

Hazbi Bajra